



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 60/1 Prot.,

Tiranë, më 04.02. 2022

URDHËR

Nr. 17, datë 04.02. 2022

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË
POPULLIT**

Mbështetur në nenin 35 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022", si dhe nenit 5 dhe 55 të Rregullores së Brendshme të Punës, miratuar me Urdhrin nr. 182, datë 15.07.2016 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e strukturës së Institucionit të Avokatit të Popullit, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës, sipas lidhjes nr.2, bashkëlidhur.
3. Urdhri nr. 252, datë 22.11.2018, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca
ERINDA BALLANCA

Konceptoi: Marjeta Sanxhaku *Marjeta Sanxhaku*


Aprovoi: Dejana Burgjia *Dejana Burgjia*

Miratoi: Fatbardh Zenelaj *Fatbardh Zenelaj*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Memo

Drejtuar: Znj. Erinda BALLANCA
Avokati i Popullit

Përgatiti: Z. Fatbardh ZENELAJ
Sekretar i Përgjithshëm

Znj. Dejana BURGIJA
Drejtores, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve

Datë: 01 shkurt 2022

Lënda: Mbi miratimin e strukturës dhe organigramës së re të institucionit të
Avokatit të Popullit

E nderuar znj. Avokate,

Mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit.

Caktimi i strukturës administrative nga vetë institucioni konsiderohet një faktor i rëndësishëm i pavarësisë së tij. Aftësia e institucionit për të krijuar strukturat e veta dhe fleksibiliteti i përshtatjes së tyre në mënyrë që t'u përgjigjen sa më mirë funksioneve e detyrave të institucionit, është mjaft e rëndësishme për funksionimin efikas të një institucioni të pavarur kushtetues, siç është Avokati i Popullit.

Siç jeni në dijeni, struktura aktuale në fuqi është miratuar me Urdhrin e brendshëm nr.42, datë 18.02.2020 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 252, datë 22.11.2018, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", i ndryshuar.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2022 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, institucioni kërkoi miratimin e shtesës për 3 (tre) punonjës të nivelit ndihmëskomisioner duke paraqitur argumentet përkatëse.

Këto kërkesave lidheshin për shkak të burimeve të kufizuara të kapaciteteve njerëzore të institucionit të Avokatit të Popullit, i cili që prej vitit 2016, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nuk i ishin miratuar asnjë shtesë në burime njerëzore.

Në pamundësi të miratimit të 3 (tre) punonjësve të rinj, gjatë diskutimeve të zhvilluara në Komisionin e Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut për çështjet e buxhetit, nga përfaqësuesit e institucionit në këtë seancë dëgjimore u kërkuar, si plotësisht e mundshme dhe e nevojshme, vlerësimi i mundësisë të miratimit të paktën të një ndihmëskomisioneri, kërkesë e cila gjeti mirëkuptimin nga përfaqësitë e jo vetëm të këtij komisioni por dhe nga përfaqësitë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë prezent në këtë seancë dëgjimore.

Me miratimin e ligjit nr.115/2021, *“Për buxhetin e vitit 2022”*, u konstatua se numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2022 është 57 (*pesëdhjetë e shtatë*) nga 56 (*pesëdhjetë e gjashtë*) që ishte. Kjo shtesë erdhi si rrjedhojë e kërkesës për shtimin e të paktën një ndihmëskomisioneri, i cili sipas propozimit Tuaj do të jetë pjesë e Seksionit të Përgjithshëm, dhe për rrjedhojë, duhet të reflektohet edhe tek struktura aktuale e institucionit.


Roli i tij si ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm do të fokusohet në çështjet që lidhen me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në përputhje kjo dhe me Rezolutën e Kuvendit, miratuar më datë 5.3.2019, *“Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”*, por edhe në mbulimin e të drejtave të tjera specifike që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Seksionit përkatës si edhe trajtimin të çështjeve që i përkasin fushave të tjera, gjithnjë brenda mandatit të Avokatit të Popullit të dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Nisur nga pozicioni i punës, çështjet që do të trajtojnë si dhe kriteret dhe eksperiencia që do të kërkojnë për to, vlerësojmë që pagesa për këtë pozicion pune duhet të jetë e kategorisë II-a, në përputhje të plotë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.187, datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”*, i ndryshuar.

Efektet financiare

Ndryshimi e sipër-përmendura realizohet brenda numrit të përgjithshëm të miratuar për njësinë e qeverisjes qendrore sipas ligjit për buxhetin e vitit 2022, e cila është shoqëruar dhe me akordimin e buxhetit përkatës për këtë shtesë në burime njerëzore.

LIDHJA NR.1



shk

sh

9/03

Ad

Lidhja Nr.2

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (57)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti -Drejtor Kabineti -Këshilltar -Sekretar	7 1 5 1	 VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar I-b VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
- Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre - Komisioner - Ndihmëskomisioner - Ndihmëskomisioner	7 1 3 3	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor - Komisioner - Ndihmëskomisioner - Ndihmëskomisioner	5 1 2 2	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni i Përgjithshëm - Komisioner - Ndihmëskomisioner - Ndihmëskomisioner	6 1 4 1	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b
Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve - Komisioner - Ndihmëskomisioner - Ndihmëskomisioner	4 1 2 1	 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar II-a II-b

Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues - Komisioner - Ndihmëskomisioner - Ndihmëskomisioner	5	
	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
	2 2	II-a II-b
Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve - Drejtor	18	II-b
Spektori i Burimeve Njerëzore - Përgjegjës Spektori i Burimeve Njerëzore - Specialist për Burimet Njerëzore - Specialist Protokolli	1 1 1	III-a III-b III-b
Spektori i Shërbimeve - Përgjegjës i Shërbimeve - Arkivist/Bibliotekar - Shofer i titullarit - Shofer - Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme - Punëtor pastrimi	1 1 1 2 1 2	III-a Klasa VIII Klasa VI Klasa IV Klasa VI Klasa I
Spektori i Financës dhe Prokurimeve -Përgjegjës Spektori -Specialist i Financës -Specialist i Prokurimeve	1 1 1	III-a III-b III-b
Spektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve - Përgjegjës sektori - Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	1 2	III-a III-b
- Spektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian - Përgjegjës Spektori - Specialist	3 1 2	 III-a III-b